



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 5/8 Prot

Vlorë, më 22 . 04 . 2022.

VENDIM

Nr.4, datë 14.04.2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË NDRYSHME (SANITARE), TË SUBJEKTIT "LINEKX1" SH.P.K, ME VENDNDODHJE, FSHATI GORICË, BASHKIA DROPULL, QARKU GJIROKASTËR



Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë "LINEKX-1" sh.p.k, "Kërkesë për leje për nxjerrje dhe shfrytëzime të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme (sanitare), me vendndodhje, Fshati Goricë, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastrë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet:
Akuiferi karstik i Malit të Gjërë
Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH)
X=520067.94; Y=4426534.78; Z=223 m.m.n.d
Prurja e ujit të kërkuar: Q=0.05 l/sek
Thellësia e pus-shpimit: 108m
Thellësia e vendosjes së pompës : 80m
Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

X=520022.14; Y=4426693.34; Z=236 m.m.n.d

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

X=520078.58; Y=4426574.72; Z=225 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: Q=0.048 l/s 3.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI
FLAMUR MAMAJ

